

TERMAT E REFERENCËS

Pozicioni: Specialist Komunikimi

Institucioni përfitues: Agjencia Kombëtare e Rinisë (PP02), Shqipëri

Emri i projektit: HARMONY Shëndeti dhe Qëndrueshmëria: Fuqizim Mendor për të Rinj

Kodi i projektit: 03C1055

Programi i financimit: Interreg Europe

Instrumenti i politikës i adresuar: Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029

Kohëzgjatja e projektit: 1 maj 2025 — 30 prill 2028

Data e fillimit të kontratës: 5 Shtator 2025

Data e përfundimit të kontratës: 30 prill 2028

Vendi i angazhimit: Tiranë, Shqipëri

Raporton te: Menaxheri i Projektit dhe Koordinatori për Monitorim Institucional

1. Konteksti i projektit

Projekti **HARMONY Health and Resilience: Mental Empowerment for New Youth**, financuar nga programi Interreg Europe, synon të nxisë përmirësimin e politikave publike në lidhje me shëndetin mendor të të rinjve përmes shkëmbimit ndërrajonal të praktikave të mira, bashkëpunimit institucional dhe përfshirjes aktive të komuniteteve rinore.

Si pjesë e këtij projekti, **Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)** ka rol thelbësor në ndërtimin e një rrjeti efektiv të komunikimit publik dhe institucional për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e politikave mbështetëse për shëndetin mendor të të rinjve në Shqipëri. Komponenti i komunikimit është veçanërisht i rëndësishëm për garantimin e transparencës, përfshirjes dhe shtrirjes së impaktit të projektit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Qëllimi i pozicionit

Specialisti i Komunikimit është përgjegjës për zbatimin e strategjisë së komunikimit të projektit në nivel kombëtar dhe për sigurimin që aktivitetet, rezultatet dhe mesazhet kryesore të projektit të shpalosen në mënyrë të qartë, vizibile dhe të sinkronizuar me udhëzimet e komunikimit të programit Interreg Europe.

Ky pozicion nuk mbart përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes tematike ose administrative të projektit, por ka rol strategjik në prodhimin e përmbajtjes vizuale, informuese dhe ndërgjegjësuere të projektit në publikun e gjerë.

3. Detyra dhe përgjegjësi

- Harton dhe zbaton planin e komunikimit të AKR-së në kuadër të projektit HARMONY, në përputhje me strategjinë e përgjithshme të komunikimit të miratuar nga partneri drejtues dhe partneri këshillues.
- Prodhon dhe shpërndan materiale komunikimi në të dy gjuhët (shqip dhe anglisht), përfshirë postera, infografikë, newsletter-e, fotograf profesionale, përmbajtje për rrjetet sociale, njoftime për shtyp dhe video të shkurtra.
- Ndihmon në krijimin dhe menaxhimin e një pranije aktive në rrjete sociale të dedikuara për projektin, duke ndjekur një kalendar editorial dhe përdorur gjuhë të përshtatshme për audiencën e re.
- Koordinon veprimtaritë e ndërgjegjësimit dhe shpërndarjes publike të projektit, përfshirë organizimin e aktiviteteve kombëtare publike (ngjarje promovuese, forume, aktivitete me të rinjtë).
- Punon me të rinjtë për të bashkëkrijuar përmbajtje multimediale që nxisin mesazhe pozitive për shëndetin mendor dhe aktivizimin rinor.
- Bashkëpunon me Specialistin e Komunikimit të partnerit këshillues dhe komunikuesit e tjerë të partnerëve për përgatitjen e fushatave të përbashkëta dhe shkëmbimin e përvojës.
- Siguron përputhjen e materialeve me standardet e identitetit vizual të Interreg Europe dhe Manualit të Komunikimit.
- Kontribuon në raportimet gjashtëmujore të projektit me të dhëna mbi aktivitetet, rezultatet dhe impaktin e komunikimit.

4. Kualifikime të kërkuara

- Diplomë universitare në një nga fushat e mëposhtme: Komunikim, Gazetari, Media, Marrëdhënie me Publikun, Marketing, Shkenca Sociale ose fusha të afërta.
- Minimum 3 vite përvojë profesionale në fushën e komunikimit publik, me përfshirje në projekte me financim nga BE ose partnerë ndërkombëtarë.
- Aftësi të avancuara në shkrimin e përmbajtjes institucionale dhe krijimin e përmbajtjes vizuale për platforma të ndryshme (dizajn grafik, video, rrjete sociale).
- Eksperiencë në menaxhimin e komunikimit institucional, ngjarjeve publike dhe ndërveprim me median.
- Njohje shumë e mirë e gjuhës shqipe dhe angleze (në të shkruar dhe në të folur).
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, në koordinim me aktorë të ndryshëm dhe për të respektuar standardet dhe afatet ndërkombëtare të komunikimit.